



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



# REZULTATET E MONITORIMIT

**TË RAPORTIMIT TË MEDIAVE LIDHUR ME TEMAT  
ME INTERES SHOQËROR, TË DEFINUARA  
BASHKËRISHT NGA ANA E GAZETARËVE  
DHE PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE  
CIVILE NË MAQEDONI**





# **REZULTATET E MONITORIMIT**

**TË RAPORTIMIT TË MEDIAVE LIDHUR ME TEMAT  
ME INTERES SHOQËROR, TË DEFINUARA  
BASHKËRISHT NGA ANA E GAZETARËVE  
DHE PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE  
CIVILE NË MAQEDONI**

**Shkup, dhjetor 2013**

**Boton:**

Rrjeti ballkanik i investigimit dhe raportimit (BIRN) – Maqedoni  
Bul. JNA 24-1/2, 1000 Shkup, Maqedoni  
Tel/Faksi: +389 2 3290 280  
e-mail: office.macedonia@birn.eu.com  
web: www.birn.eu.com

**Përgatiti:**

Qendra e Komunikimeve Qytetare  
Bul. Koço Racin nr. 26-1/2, 1000 Shkup, Maqedoni  
Tel/Faksi: +389 2 3213 513  
Web: www.ccc.org.mk

**Përktheu:**

Ilir Ivanovski

**Shtyp:**

**Tirazhi:** 150

Kopje falas/jokomerciale










Ky raport është mundësuar me mbështetjen e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë amerikane të zhvillimit ndërkombëtar (USAID) në kudër të Projektit të gazetarisë hulumtuese dhe bashkëpunimit midis mediave dhe sektorit civil, Programi i USAID për forcimin e pavarësisë së mediave në Maqedoni. Përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi është Rrjeti ballkanik i investigimit dhe raportimit, ndërsa vetë publikimi nuk pasqyron qëndrimet e USAID dhe ato të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

**Partnerët e projektit**

---



# PËRMBAJTJA

-  **HYRJE** 6
-  **METODOLOGJIA** 8
-  **REZULTATET E MONITORIMIT** 10
  -  Konstatimet kryesore 10
  -  Rezultatet e detajuara 12
  -  Rezultatet e monitorimit sipas temave 20
    - 
  -  Krahasimi i mënyrës së raportimit sipas temave 30
-  **REKOMANDIMET** 34



# HYRJE

Mediat janë një nga faktorët më të rëndësishëm shoqëror me ndihmën e të cilit qytetarët informohen lidhur me çështjet me interes publik. Në rrethana të tilla mediat kanë për detyrë t'u mundësojnë qytetarëve të fitojnë informatat e nevojshme për të marrë një qëndrim lidhur me çështje të caktuara me interes publik. Në këtë kontekst, duke u siguruar qytetarëve informata relevante dhe objektive, mediat ndikojnë në ngritjen e nivelit të përgjithshëm të kuptimit të politikave publike, duke lënë hapësirë për debate publike lidhur me politikat konkrete në të cilat përfshihen të gjithë faktorët shoqërorë. Nga ana tjetër, me rolin e mbrojtësit të interesit publik, mediat duke vepruar në emër të popullatës, hapin debate lidhur me probleme të caktuara të shoqërisë dhe bëjnë presione mbi pushtetin dhe mbi qendrat e ndryshme të interesit për të gjetur zgjidhje të problemeve konkrete.

Që mediat të jenë në gjendje të realizojnë me sukses rolin e tyre shoqëror, ato kanë nevojë për kushte pune adekuate, definimin dhe respektimin e standardeve etike dhe profesionale, por edhe për bashkëpunim me faktorët e tjerë shoqëror me fushëveprim të ngjashëm dhe që mbrojnë interesa të ngjashme. Në këtë kontekst, para së gjithash bëhet fjalë për bashkëpunimin me organizatat civile që gjithashtu janë një faktor shumë i rëndësishëm i shoqërisë civile, i cili kryesisht angazhohet për avancimin e politikave publike dhe për të siguruar një qasje sa më të mirë të qytetarëve në fushat e ndryshme të vendimmarrjes në shoqëri.

Në mbështetje të të sipërpërmendurës, Projekti i gazetarisë investigative dhe bashkëpunimit të mediave dhe sektorit civil, si pjesë e Programit të USAID për forcimin e pavarësisë së mediave në Maqedoni, hulumtoi mënyrën e raportimit të mediave lidhur me çështjet me interes të përgjithshëm shoqëror dhe bashkëpunimin e mediave me organizatat civile gjatë raportimit të këtij lloji.

Monitorimi kishte për qëllim të sigurojë informata të mjaftueshme cilësore dhe relevante për analizimin e mënyrës në të cilën mediat në Maqedoni raportojnë lidhur me çështjet me interes shoqëror, të definuara me një debat të përbashkët të përfaqësuesve të organizatave civile dhe gazetarëve.

Analiza e rezultateve të monitorimit gjithashtu shërbeu edhe si një bazë për organizimin e punëtorive me gazetarë dhe organizata civile lidhur me rritjen e numrit dhe ngritjen e cilësisë së teksteve të mediave që kanë të bëjnë me temat e zgjedhura me interes të përbashkët.

Monitorimi, ndër të tjera, mundësoi përgjigje të çështjeve kryesore në vijim:

- Me çfarë intensitet mediat maqedonase raportojnë mbi temat e analizuara?
- Sa respektohen standardet profesionale kryesore të gazetarisë gjatë raportimit lidhur me temat konkrete?
- Sa është i balancuar dhe objektiv raportimi i mediave dhe sa konsultohen të gjitha anët e një historie konkrete?
- A janë tekstet e gazetarëve rezultat të hulumtimeve të tyre ose bëhet fjalë për raportime lidhur me ngjarjet e organizuara për me këto tema?
- Sa janë të besueshme dhe relevante dhe cili është kredibiliteti i teksteve?

Përveç qëllimit kryesor, rezultatet e monitorimit mund të shërbejnë edhe si një bazë për të filluar aksione të tjera që do të kenë për qëllim përmirësimin e raportimit të mediave në përgjithësi, por edhe në veçanti për secilën nga temat e analizuara. Këto rezultate mund të ndihmojnë gazetarët për të detektuar pikat e dobëta të informimit të tanishëm dhe t'u shërbejnë si një udhërrëfyes për përmirësimin e raportimit të tyre. Ndërkaq, kjo analizë mund të ndihmojë organizatat për të detektuar dobësitë që kërkojnë një angazhim më të madh për të informuar opinionin rregullisht, në mënyrë profesionale dhe me objektivitet më të madh.



# METODOLOGJIA

Bëhet fjalë për monitorimin e mënyrës në të cilën mediat e zgjedhura raportojnë për dhjetë tema me interes shoqëror, tema këto të zgjedhura nga ana e gazetarëve dhe përfaqësuesve të organizatave civile.

Mediat, tekstet<sup>1</sup> e të cilave analizohen, janë zgjedhur në mbështetje të gjendjes së tyre, qëllimet e monitorimit, nevojat e analizimit të rezultateve të monitorimit, parimeve të projektit dhe përvojës së mëparshme në këtë fushë. Ndërkaq, gjatë zgjedhjes së mediave u mor parasysh rëndësia e tyre, shikueshmëria/lexueshmëria e tyre, prania e mediave elektronike dhe të shtypura, prania e mediave lokale dhe nacionale, mediave në gjuhën maqedonase dhe shqipe dhe mediave me prona të ndryshëm dhe politikë të ndryshme redaktuese.

Për qëllimet e analizës janë zgjedhur mediat në vijim:

- ➔ TVM1 – televizioni shtetëror, servisi publik në gjuhën maqedonase;
- ➔ Alsat M – televizioni nacional në gjuhën shqipe;
- ➔ TV Tera – televizioni lokal (rajonal) në gjuhën maqedonase në Manastir;
- ➔ Dnevnik – e përditshmja nacionale në gjuhën maqedonase dhe
- ➔ Vest<sup>2</sup> – e përditshmja nacionale në gjuhën maqedonase.

Objekt i monitorimit direkt ishin tekstet e këtyre mediave lidhur me temat e zgjedhura dhe një pjesë e këtyre temave të publikuara gjatë periudhës 1 prill – 30 qershor të vitit 2013.

Bëhet fjalë për kombinimin e një monitorimi kuantitativ dhe kualitativ, i cili përveç të dhënave numerike ka siguruar edhe informata lidhur me cilësinë e teksteve të analizuara, në aspektin e respektimit të standardeve profesionale të gazetarisë.

---

1 Fjala “tekstet” nënkupton tekstet gazetareske të publikuara në gazetatat dhe kronikat dhe informatat e tjera që mund të ndiqen gjatë lajmeve.

2 Sipas planit, në vend të gazetës “Vest”, pjesë e mediave të zgjedhur ishte dashur të jetë e përditshmja në gjuhën maqedonase “Fokus”, por si rezultat të mospublikimit të kësaj gazete, e njëjta u zëvendësua me gazetën “Vest”, si gazeta më e ngjashme me të.



Tekstet e publikuara dhe përmbajtja e tyre, ndër të tjera, u analizuan lidhur me aspektet në vijim:

- Fusha/tema e trajtuar me tekstet;
- Faqja/pjesa e lajmeve në të cilën është publikuar/transmetuar teksti ose kronika;
- Rubrika në kuadër të të cilës është publikuar teksti;
- Gjatësia e tekstit/kohëzgjatja e kronikës;
- Paralajmërimi i tekstit/lajmit në ballinë;
- Ilustrimi i tekstit;
- Autori i tekstit/kronikës;
- Lloji i zhanrit të tekstit;
- Numri, statusi dhe lokacioni i burimeve;
- Qasja fer dhe e balancuar;
- Arsyeja për të cilën është shkruar teksti;
- Konsultimi i palëve të prekura dhe mënyra në të cilën është transmetuar mendimi i saj etj.

Monitorimi u realizua me ndihmën e plotësimit (në mënyrë të koduar dhe me përshkrim) të pyetësorëve (formularëve) të përgatitur dhe të strukturuar paraprakisht për monitorim. Më konkretisht u monitorua çdo tekst i gjetur lidhur me një nga temat e zgjedhura.

Pyetësorët/formularët pas plotësimit të tyre u shqyrtuan, proceduan dhe sublimuan në një matricë të veçantë, me të cilën u siguruan rezultatet përmbledhëse të monitorimit, të cilat shërbyen si bazë për përgatitjen e analizës.

Objekt i analizës ishin rezultatet përmbledhëse të monitorimit dhe jo rezultatet e veçanta të mediave të monitoruara.



# REZULTATET E MONITORIMIT



## Konstatimet kryesore

- Mediat raportojnë rregullisht mbi temat e analizuara, duke publikuar mesatarisht nga 4 tekste në ditë, tekste që kanë të bëjnë me dhjetë temat e zgjedhura me interes shoqëror. Kjo mesatare është më e lartë tek mediat e shtypura (6 tekste në ditë nga 10 temat e analizuara), ndërsa dy herë më e ulët është tek televizionet (3 tekste nga 10 temat e analizuara).
- Mediat zakonisht raportojnë për “Anëtarësimin në Bashkimin Evropian”, ndërsa pas kësaj teme, në mënyrë të barabartë, trajtohen temat që kanë të bëjnë me “Cilësinë e jetës”, “Shëndetësinë dhe të drejtat e pacientëve” dhe “Sundimin e drejtë”. Tema për të cilën mediat kanë raportuar më pak është “Përfshirja e grupeve të marginalizuara në shoqëri”, ndërsa pas saj vijojnë temat që kanë të bëjnë me “Politikën kulturore” dhe “Raportet ndëretnike”, si temat me prani më të vogël në mediat.
- Shumica e teksteve nuk i plotësojnë standardet profesionale kryesore, mungon besueshmëria dhe kredibiliteti, ndërsa pjesa më e madhe e temave dhe problemeve trajtohen në formën e informatave, në mënyrë sipërfaqësore dhe pa investigime dhe analiza gjithëpërfshirëse dhe të detajuara;
- Shumica e teksteve dhe temave të analizuara nuk paralajmërohen në ballinat e gazetave ose gjatë siglës së lajmeve kryesore dhe nuk shoqërohen me fotografi/filmime ose shoqërohen me fotografi/filmime të përgjithshme që nuk kanë lidhje direkte me ngjarjet ose individët që trajtohen me tekstin/kronikën përkatëse.
- Në shumicën e rasteve nuk publikohet emri i autorit të tekstit (shënohet emri dhe mbiemri ose inicialet e autorit), ndërsa një e katërta e teksteve janë tekste pa autor ose tekste anonime.
- Nga aspekti i zhanrit, pjesa më e madhe e teksteve janë lajme, ndërsa vetëm 3% janë storje investigative.
- Pak më shumë se gjysma e teksteve kanë vetëm një burim, ndërsa pa burim publikohen ose botohen 7% të teksteve. Në pjesën më të madhe të teksteve shënohen burimet e të dhënave ose informatave, ndërsa vetëm në 3% prej tyre burimet

mbeten anonime. Ndërkaq, për dy të tretat e teksteve është konsultuar vetëm njëra anë e storjes.

- 🔑 Si burime të dhënash në të shumtën e rasteve gjatë përgatitjes janë marrë institucionet shtetërore, midis të cilave dominojnë ministrinë. Organizatat joqeveritare si burime të dhënash janë marrë në shumë pak raste.
- 🔑 Pala e prekur nuk është konsultuar në dy të tretat e teksteve. Në rastet kur ajo është konsultuar, në një të tretat e këtyre rasteve, ajo ka dhënë deklaratën e kërkuar, ndërsa në shumë pak raste kjo palë ka vendosur të mos jap deklaratë.
- 🔑 Në dy të tretat e rasteve tekstet janë përgatitur për një ngjarje pseudo (konferencë për shtyp, njoftim, deklaratë etj.), për 18% prej tyre gazetarët kanë përdorur ngjarjet aktuale ose autentike, ndërsa në 9% të rasteve tekstet janë përgatitur si rezultat të investimeve të gazetareve.
- 🔑 Rreth gjysma e teksteve janë përgatitur pas organizimit të një ngjarjeje konkrete nga ana e institucioneve shtetërore, ndërsa në 10% të rasteve në rolin e organizatorit kanë qenë organizatat joqeveritare.

Me analizimin e raportimit të mediave sipas temave mund të sigurohen konstatimet kryesore në vijim:

- 🔑 “Kultura politike”, megjithëse është një nga temat me prani më të vogël në mediat, veçohet si tema për të cilën mediat kanë raportuar me profesionalizëm më të madh.
- 🔑 Tema më e paralajmëruar në ballinë ose në siglat e lajmeve kryesore është “Anëtarësimi në Bashkimin Evropian”, ndërsa tema me prani më të vogël është “Ambienti jetësor”.
- 🔑 Tema me më shumë fotografi/filmime origjinale është “Politika kulturore”, ndërsa tema me më pak fotografi/filmime origjinale është “Ambienti jetësor”.
- 🔑 Tema e vetme për të cilën emri i autorit është publikuar në çdo rast është “Politika kulturore”, për dallim nga tema “Ambienti jetësor”, temë kjo për të cilën emri i autorit nuk është publikuar në gjysmën e teksteve.
- 🔑 Megjithëse për temën “Politika kulturore” janë përgatitur shumë pak tekste, për këtë temë janë përgatitur më shumë storje investigative, ndërsa për temat “Cilësia e jetës” dhe “Përfshirja e grupeve të marginalizuara” nuk është përgatitur asnjë storje investigative.
- 🔑 Nga aspekti i numrit të burimeve të të dhënave, tema me më shumë tekste me dy ose më shumë burime të dhënash është tema “Politika kulturore”, ndërsa tema me më shumë tekste me një burim të dhënash (69%) është tema “Sundimi i mirë”.
- 🔑 Për sa i përket çështjes së statusit të burimeve të të dhënave, tema për të cilën janë shënuar të gjitha burimet e të dhënave është “Përfshirja e grupeve të marginalizuara në shoqëri”, ndërsa tema me më shumë burime anonime është “Sundimi i mirë”.
- 🔑 Tema me më shumë tekste pa burime të dhënash (19%) është “Anëtarësimi në BE”, ndërsa tema për të cilën nuk ka pasur tekst pa burim të dhënash është “Përfshirja e grupeve të marginalizuara në shoqëri”.

- 🔑 Për sa i përket palëve të trajtuara me tekstet, temat me më shumë tekste me të cilat janë konsultuar dy dhe më shumë palë është “Arsimi dhe të rinjtë”, ndërsa temat për të cilat me pjesën më të madhe të teksteve është konsultuar vetëm njëra palë janë “Ambienti jetësor” dhe “Sundimi i mirë”.
- 🔑 Tekstet me më shumë burime të dhënash të siguruara nga sektori civil janë përgatitur për temat “Përfshirja e grupeve të marginalizuara në shoqëri” dhe “Të drejtat e njeriut”, ndërsa tema në të cilën sektori civil nuk është marrë si burim të dhënash është “Kultura politike”.
- 🔑 Tema me më shumë tekste për të cilat burimet e të dhënave janë siguruar në kuadër të institucioneve shtetërore (qeveria, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore dhe lokale) është „Marrëdhëniet ndëretnike“.
- 🔑 Pala e prekur me një ngjarje konkrete më shumë është konsultuar me tekstet e temave “Politika kulturore” dhe “Arsimi dhe të rinjtë”, ndërsa kjo palë më pak është konsultuar me tekstet e temës “Cilësia e jetës”.
- 🔑 Ngjarjet pseudo zakonisht janë motiv për përgatitjen e teksteve të temës “Sundimi i mirë”, ndërsa ngjarjet autentike zakonisht janë motiv për përgatitjen e teksteve të temës “Politika kulturore”, temë kjo për të cilën shumica e teksteve janë përgatitur si rezultat të investigimeve të gazetarëve.
- 🔑 Tema me më shumë tekste për të cilat si organizator i ngjarjeve paraqitet një organizatë joqeveritare është “Përfshirja e grupeve të marginalizuara në shoqëri”, ndërsa temat me më pak tekste për të cilat si organizator i ngjarjeve paraqitet një organizatë joqeveritare janë “Cilësia e jetës” dhe “Politika kulturore”.



## Rezultatet e detajuara

Objekt monitorimi dhe analize ishin gjithsej 384 tekste lidhur me dhjetë temat me interes shoqëror, të cilat u publikuan në mediat e zgjedhura gjatë periudhës së monitorimit. Duke ditur që gjatë periudhës së monitorimit pesë mediat e zgjedhura kanë pasur 97 botime/edicione, në nivel ditor janë publikuar nga katër tekste lidhur me temat e analizuara. Ndërkaq, gazetatat çdo ditë kanë publikuar mesatarisht nga gjashtë tekste, ndërsa televizionet kanë transmetuar mesatarisht nga tre kronika.

Tema më e pranishme ose tema për të cilën mediat kanë publikuar më shumë tekste gjatë periudhës së monitorimit është “Anëtarësimi në BE”, ndërsa pas kësaj, me një numër të përafërt tekstesh, vijojnë temat “Cilësia e jetës”, “Shëndetësia dhe të drejtat e pacientit” dhe “Sundimi i mirë”. Tema me më pak tekste ose tema me prani më të vogël në dhjetë mediat e analizuara është “Përfshirja e grupeve të marginalizuara në shoqëri”, ndërsa tema me më pak tekste të publikuara janë dhe “Politika kulturore”, “Marrëdhëniet ndëretnike” dhe “Ambienti jetësor”.


Megjithëse bëhet fjalë për tema me interes shoqëror për të cilat pritet që tekstet gazetareske të jenë më të gjata, vetëm pak më shumë se një e treta e teksteve të analizuara kanë qenë të gjata (38%). Një numër i përafërt i teksteve kanë qenë të shkurtra (34%), ndërsa tekstet e tjera kanë qenë tekste të mesme (28%). E gjithë kjo flet për elaborimin e pamjaftueshëm dhe për hapësirën e vogël që u jepet këtyre temave në mediat vendase.

## 1. Temat për të cilat janë shkruar tekstet




Tre të katërtat e teksteve (75%) nuk janë paralajmëruar në ballinat e gazetave ose në siglat e lajmeve kryesore të televizioneve. Publikimi i teksteve në ballinë ose në siglat e lajmeve kryesore zakonisht lidhet me cilësinë e tyre. Më saktësisht, nëse mediat vlerësojnë se teksti zbulon diçka të rëndësishme dhe me interes të madh për publikun, në një rast të tillë teksti paralajmërohet në ballinë ose në siglën e lajmeve kryesore, për të tërhequr vëmendjen e sa më shumë lexuesve ose shikuesve. Në këtë kontekst, në ballinë ose në siglën e lajmeve kryesore janë paralajmëruar vetëm një e katërta e teksteve (25%) të publikuara lidhur me temat me interes shoqëror.

## 2. Gjatësia e teksteve




Ky numër përputhet me numrin e teksteve që mund të vlerësohen si tekste më cilësore nga aspekti i numrit të burimeve të të dhënave, pranisë së palëve të prekura me vetë tekstin, konsultimin dhe citimin e palëve të prekura etj. E gjithë kjo do të thotë se në ballinat e gazetave ose në siglat e lajmeve kryesore janë paralajmëruar tekstet më cilësore, që mund të rezultojë me konkluzionin se mediat janë të vetëdijshme për cilësinë e punës së tyre dhe në rast se do të kishin më shumë tekste cilësore ato do t'i paralajmëronin në ballinat e tyre ose në siglat e lajmeve kryesore.

### 3. A është publikuar teksti në ballinë / në fillimin e lajmeve kryesore?



Më shumë se gjysma e teksteve nuk përmbajnë fotografi (21%) ose janë ilustruar me fotografi të përgjithshme që kanë të bëjnë me temën konkrete (41%). Pjesa e mbetur e teksteve, 38% prej tyre, janë ilustruar me fotografi ose filmime origjinale dhe autentike që kanë lidhje direkte me çështjen e trajtuar. Krijohet përshtypja se prania e fotografive/filmimeve autentike nuk është e mjaftueshme sepse për temat me interes shoqëror është me rëndësi të madhe që në të gjitha rastet kur është e mundur një gjë e tillë ato të shoqërohen me fotografi/filmime origjinale, të cilat bashkë me tekstin ndihmojnë qytetarët për të kuptuar më mirë dhe plotësisht problematikën dhe për t'u informuar më mirë.

### 4. A është shoqëruar teksti me fotografi / filmime?




Për rreth gjysmën e teksteve (49%) që kanë të bëjnë me temat me interes shoqëror autori ka mbetur i panjohur. Për gjysmën tjetër të teksteve (22%) autori është shënuar me iniciale, teksti është marrë nga një media tjetër (4%) ose autori është i panjohur (25%).

Përqindja e lartë e teksteve për të cilat autori ka mbetur i panjohur ose janë shënuar vetëm inicialet e tij lidhet me zhanrin e tyre ose me faktin që pjesa më e madhe e tyre janë lajme të shkurtra për të cilat autorët zakonisht nuk shënohet ose shënohen vetëm inicialet e tyre.

Duke ditur që vetëm 3% e numrit të përgjithshëm të teksteve janë storje investigative, ndërsa pa emrin e autorit janë 25% të teksteve, nuk mund të merret konkluzioni se pa emrin e autorit mbeten tekste me të cilat gazetarët kanë publikuar informata të rëndësishme, ndërsa identiteti është fshehur për të mbrojtur gazetarin ose redaksitë qëllimisht kanë qëndruar pas storjeve të caktuara investigative dhe për këtë arsye nuk kanë publikuar emrin e gazetarit.


Publikimi i emrit të autorit të tekstit vlerësohet si shumë i rëndësishëm për kredibilitetin e medias përkatëse që në fakt rrit besimin e lexuesit/shikuesit. Ndërkaq, tekste pa emrin e autorit nuk gëzojnë besimin e duhur dhe lënë hapësirë për dyshime sipas të cilave arsyeja kryesore e tekstit konkret nuk ka të bëjë me informimin objektiv të opinionit.

#### 5. A është shënuar emri i autorit të tekstit?




Megjithëse bëhet fjalë për tema me interes shoqëror, që në fakt kërkon praninë e zhanreve të tjera gazetareske përveç lajmeve, tre të katërtat e teksteve i takojnë zhanrit lajme (74%). Pas lajmeve vijojnë analizat me 10%, komentet me 7%, reportazhet dhe revistat me 3% të teksteve. Storjet investigative janë të pranishme në 3% të teksteve të analizuara. Këto shifra janë alarmuese duke ditur që një pjesë e madhe e temave të zgjedhura janë të përshtatshme për investigime ose informimi objektiv i popullatës lidhur me këto tema është i mundur vetëm nëpërmjet investigimeve gjithëpërfshirëse të gazetarëve.

## 6. Zhanri gazetaresk i teksteve / kronikave



Kur bëhet fjalë për burimet e të dhënave, mbi gjysma e teksteve kanë vetëm një burim (53%), ndërsa 7% prej tyre janë pa burim. Dy, tre ose më shumë burime kanë 40% të teksteve. Shënimi i burimeve me emër dhe mbiemër është një nga rregullat kryesore të gazetarisë profesionale, ndërsa vetë emri i burimit bën që teksti të jetë më i besueshëm.


## 7. Burimet - numri






Për sa i përket statusit të burimeve, dominojnë burimet e shënuara me emër dhe mbiemër (86%), ndërsa në vetëm 3% të teksteve burimet janë anonime. Burime me emër dhe mbiemër dhe burime anonime janë konstatuar në 4% të teksteve, ndërsa 7% të tyre kanë qenë pa burime.

### 8. Burime - statusi




Dy të tretat e teksteve (66%) kanë marrë vetëm njërin anë të storjes, ndërsa vetëm në 27% të teksteve janë të pranishme dy ose më shumë palë të storjes. Balancimi i burimeve ose paraqitja e të dy palëve (ose të gjitha palëve) të storjes është një rregullat kryesore të gazetarisë. Vetë fakti që një numër shumë i madh i teksteve trajton vetëm njërin anë të storjes vë në pikëpyetje objektivitetin e mediave.

### 9. Burimet - palët e storjes




Për sa u përket sektorëve të burimeve, më të pranishëm (36%) janë burimet që vijnë nga institucionet shtetërore (qeveria, ministritë, agjencitë shtetërore etj.) Burimet që vijnë nga pushteti lokal dhe nga institucionet shëndetësore janë të pranishme në 6% të teksteve, ndërsa ato që u takojnë partive politike janë të pranishme me 7%. Burimet e sektorit të biznesit janë të pranishme me 4%, ndërsa ekspertët universitarë janë të pranishëm në 3% të teksteve. Në veçanti duhet theksuar se burimet e organizatave civile marrin pjesë vetëm me 8% në të gjitha burimet e teksteve, megjithëse në secilën nga temat e analizuara me interes shoqëror janë aktive të paktën nga disa organizata civile.

### 10. Burimet - sektorët




Pala e prekur me tekstin/storjen nuk është konsultuar në rreth dy të tretat e teksteve (63%). Në tekstet në të cilat ajo është konsultuar, më saktësisht në një të tretat e tyre (33%), prej saj është marrë një deklaratë, ndërsa vetëm në 4% të teksteve pala e prekur është konsultuar, por ajo nuk ka qenë e interesuar për të dhënë deklaratë. Në mungesë të deklaratave tekstet humbin objektivitetin sepse me moskonsultimin e palës së prekur hapen dilema lidhur me trajtimin e barabartë që në fakt duhet të jetë një element i detyrueshëm i çdo teksti gazetaresk. Trajtimi i barabartë nënkupton që të gjitha palët e storjes do të trajtohen pa favorizime, ndërsa me moskonsultimin e palës së prekur me dy të tretat e teksteve në fakt është favorizuar pala tjetër e storjes konkrete.

### 11. A është konsultuar pala e prekur?




## 12. Arsyet e përgatitjes së teksteve



Ngjarjet pseudo mbajnë vendin e parë në listën e arsyeve për përgatitjen e një teksti me 60%. Në 18% të rasteve arsyeja ka qenë një ngjarje aktuale ose autentike, ndërsa në 13% arsyet e përgatitjes së teksteve nuk është mundur të definohen saktë. Vetëm në 9% të teksteve arsyeja e përgatitjes së tyre ka qenë hulumtimi i gazetarit, që do të thotë se megjithëse bëhet fjalë për tema me interes shoqëror, informimi i mediave lidhur me këto tema kryesisht varet nga faktorë të ndryshëm jashtë mediave. Në këtë mënyrë mediat nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre shumë të rëndësishëm në shoqëri, ndërsa opinioni nuk fiton informatat e pavarura dhe objektive për të cilat ka nevojë për të marrë vendime lidhur me mënyrën e të jetuarit dhe punën e tyre.

## 13. Organizatorë të ngjarjeve



Institucionet qeveritare mbajnë vendin e parë në listën e organizatorëve të ngjarjeve pseudo, të cilat në fakt kanë qenë arsyeja kryesore për të raportuar lidhur me temat me interes shoqëror. Këto institucione kanë qenë në rolin e organizatorit të ngjarjeve pseudo në 28% të rasteve. Pas institucioneve qeveritare, në listën përkatëse me 11% vijojnë institucionet e tjera publike, ndërsa pas tyre gjenden organizatat civile me 8% të ngjarjeve të organizuara mbi temat e zgjedhura. Partitë politike në rolin e organizatorit kanë qenë në 7% të rasteve, pushteti lokal në 5% prej tyre, sektori i biznesit në 4%, ndërsa institucionet gjyqësore në 2% të rasteve.



## Rezultatet e monitorimit sipas temave



### Raportimi i mediave mbi temën „Cilësia e jetës“

Tema “Cilësia e jetës” në vetvete përfshin disa nëntema: Të drejtat e konsumatorit, Standardi jetësor, punësimi i personave të papunë dhe Drejtësia sociale. Kjo temë gjendet në vendin e dytë sipas numrit të teksteve të publikuara në mediat e monitoruara gjatë periudhës së monitorimit. Një analizë më e detajuar zbardh se numri më i madh i teksteve janë publikuar lidhur me nëntemat Punësimi i personave të papunë dhe Të drejtat e konsumatorit, ndërsa nëntema me më pak tekste është Standardi jetësor.











Monitorimi i mënyrës në të cilën mediat kanë raportuar mbi këto tema zbardh rezultatet në vijim:

- ⊗ Rreth gjysma e teksteve (44%) janë tekste të gjata, ndërsa një e treta (31%) janë tekste të shkurtra;
- ⊗ Vetëm 20% të teksteve janë paralajmëruar në ballinë ose në siglat e lajmeve;
- ⊗ Rreth gjysma e teksteve (47%) janë ilustruar me fotografi origjinale/autentike ose filmime të tilla;
- ⊗ Në 27% të teksteve nuk është shënuar emri dhe mbiemri i autorit;
- ⊗ Rreth 85% të teksteve janë lajme ose lajme të zgjeruara, ndërsa 7% janë analiza;
- ⊗ Me një burim të dhënash janë publikuar 55% të teksteve, 40% prej tyre kanë dy ose më shumë burime të dhënash, ndërsa 5% të teksteve janë publikuar pa burimet e të dhënave;
- ⊗ Në 85% të teksteve janë shënuar burimet e tyre;
- ⊗ Njëra palë e storjes është konsultuar në 69% të teksteve;
- ⊗ Nga aspekti i sektorit të burimeve, si burim të dhënash dominojnë institucionet shtetërore me 48%, ndërsa pas tyre gjendet sektori i biznesit me 13%, pushteti lokal me 4% dhe organizatat civile me 3%;
- ⊗ Pala e prekur me tekstin nuk është konsultuar në 78% të teksteve, ndërsa në 20% të teksteve me të cilat ajo është konsultuar, e njëjta nuk ka dhënë deklaratë;
- ⊗ Për 60% të teksteve arsyeja e përgatitjes së tyre kanë qenë ngjarjet pseudo, për 13% të teksteve arsyeja kanë qenë ngjarjet autentike, ndërsa 5% prej tyre janë përgatitur si rezultat të investigimeve të gazetareve;
- ⊗ Për sa u përket organizatorëve të ngjarjeve, organizatat civile në asnjë rast nuk paraqiten në rolin e organizatorit.



## Raportimi i mediave mbi temën „Shëndetësia dhe të drejtat e pacientit“











Kjo temë, sipas numrit të teksteve të publikuara në mediat e analizuara, është gjetur në vendin e tretë. Me monitorimin e mënyrës në të cilën mediat kanë raportuar lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me këtë temë mund të arrihet në konstatimet e mëposhtme:

-  Rreth 81% të teksteve nuk janë paralajmëruar në ballinë ose në siglat e lajmeve kryesore;
-  Vetëm më pak se një e treta e teksteve (31%) janë ilustruar me fotografi origjinale/autentike ose filmime të tilla;
-  Në 26% të teksteve nuk është shënuar emri i autorit, ndërsa në 30% prej tyre autori është shënuar vetëm me initiale;
-  Sipas zhanrit dominon lajmi me 81%, ndërsa pas tij vijojnë analiza me 5% dhe reportazhi, skoriert hulumtuese dhe komentit me 4%;
-  Gjysma e teksteve (52%) janë publikuar vetëm me një burim të dhënash, ndërsa vetëm 4% të teksteve janë publikuar pas asnjë burim të dhënash;
-  Burimet e të dhënave janë shënuar në 91% të teksteve, ndërsa 2% prej tyre janë publikuar me burime anonime;
-  Në 69% të teksteve është konsultuar vetëm njëra palë e storjes;
-  Institucionet shtetërore me 41% dhe institucionet shëndetësore me 38% dominojnë si burime informatash, krahasuar me sektorin civil, i cili në rolin e burimit të informatave paraqitet vetëm në 3% të teksteve;
-  Pala e prekur nuk është konsultuar në dy të tretat e teksteve (67%);
-  Për më shumë se gjysmën e teksteve (57%) arsyeja e publikimit të tyre kanë qenë ngjarjet pseudo, për 22% prej tyre arsyeja ka qenë një ngjarje autentike, ndërsa në 11% të teksteve janë për-gatitur si rezultat të investigimeve të gazetarëve.



## Raportimi i mediave mbi temën „Ambienti jetësor“













Kjo është një nga temat me prani më të vogël nga dhjetë temat e analizuara me interes shoqëror, ndërsa mediat e shtypura kanë raportuar shumë më tepër krahasuar me televizionet. Analiza e teksteve të kësaj teme zbardh rezultatet në vijim:

-  Mbi gjysma e teksteve (57%) kanë qenë tekste të shkurtra, që njëkohësisht është përqindja më e madhe e teksteve të shkurtra lidhur me të gjitha temat e analizuara;
-  Rreth 88% të teksteve nuk janë paralajmëruar në ballinë ose në siglat e lajmeve kryesore, që gjithashtu është përqindja më e madhe e të gjitha temave të analizuara;
-  Gjysma e teksteve (50%) nuk janë shoqëruar me fotografi ose filmime, që paraqet përqindjen më të madhe të të gjitha temave të analizuara;
-  Autori i tekstit është shënuar vetëm në 23% të teksteve, ndërsa në 46% prej tyre autori ka mbetur anonim, që do të thotë se për këtë temë kemi përqindjen më të ulët të teksteve me autor të njohur ose përqindjen më të lartë të teksteve me autor anonim;
-  85% të teksteve janë lajme, 12% janë analiza, ndërsa 4% prej tyre janë storje investigative;
-  62% të teksteve janë publikuar vetëm me një burim të dhënash, ndërsa 4% janë publikuar pa burim të dhënash;
-  Njëra palë e storjes është konsultuar në 77% të teksteve;
-  Si burimi më i shpeshtë i informatave paraqitet pushteti lokal me 35%, i cili gjendet para institucioneve shtetërore (23%), sektorit të biznesit (12%), sektorit civil (8%) etj;
-  Në 58% të teksteve pala e prekur me storjen nuk është konsultuar dhe nuk është transmetuar mendimi i saj;
-  Arsyeja më e shpeshtë e përgatitjes së teksteve kanë qenë ngjarjet pseudo (42%), të cilat gjenden para ngjarjeve aktuale (27%) dhe investigimeve të gazetarëve (4%).



## Raportimi i mediave mbi temën „Politika kulturore“

Edhe kjo është një nga temat për të cilat mediat kanë raportuar shumë pak, më saktësisht bëhet fjalë për temën e dytë me prani më të vogël nga dhjetë temat e analizuar, e cila gjendet pas temës “Përfshirja e grupeve të marginalizuara në shoqëri”. Gazetat dhe televizionet kanë raportuar shumë pak për këto tema. Me monitorimin e mënyrës në të cilën mediat kanë raportuar mbi këtë temë, mund të sigurohen konkluzionet në vijim:

-  Dominojnë tekstet e gjata me 64%, që njëkohësisht paraqet përqindjen më të madhe të teksteve më të gjata lidhur me temat e analizuar;
-  Gjysma e teksteve janë paralajmëruar ose nuk janë paralajmëruar në ballinat e gazetave ose në siglat e lajmeve kryesore të televizioneve që nënkupton përqindjen më të madhe të teksteve të paralajmëruara lidhur me të gjitha temat e analizuar;
-  64% të teksteve janë ilustruar me fotografi origjinale dhe autentike ose filmime të tilla, që nënkupton përqindjen më të madhe të teksteve të ilustruara që janë përgatitur lidhur me të gjitha temat e analizuar;
-  Autori është shënuar me emër dhe mbiemër në 93% të teksteve që gjithashtu nënkupton përqindjen më të madhe ose përqindjen dy herë më të madhe krahasuar me mesataren e të gjitha teksteve të përgatitura lidhur me të gjitha temat e analizuar;
-  Për sa i përket gjatësisë së teksteve, kjo është tema e vetme në të cilën nuk dominon zhanri lajme, por me një numër të madh tekstesh janë të pranishme edhe zhanret e tjera, siç janë reportazhi me 29%, storjet investigative me 21% dhe intervista dhe komenti me 7%;
-  64% të teksteve janë përgatitur me dy ose më shumë burime të dhënash, që nënkupton përqindjen më të madhe të të gjitha temave të analizuar, krahasuar me 29% të teksteve me vetëm një burim të dhënash, që nënkupton përqindjen më të ulët të të gjitha temave të analizuar;
-  Përveç burimit të të dhënave, kjo temë mban edhe përqindjen më të lartë të burimeve anonime (7%);
-  Pala e prekur me storjen nuk është konsultuar në 64% të teksteve;
-  Institucionet e kulturës janë burimet më të shpeshta të informatave (32%), ndërsa pas tyre vijnë institucionet shtetërore (37%), ekspertët universitarë (11%) dhe partitë politike (5%). Për përgatitjen e teksteve si burim të dhënash nuk është marrë sektori civil;
-  Në 50% të teksteve është konsultuar pala e prekur me storjen, ndërsa në 43% është transmetuar edhe mendimi i palës së prekur, që nënkupton përqindjet më të larta të të gjitha temave të analizuar;
-  Megjithëse ngjarjet pseudo kanë qenë arsye për përgatitjen e 50% të teksteve, kjo është përqindja më e ulët nga të gjitha temat e analizuar, ndërsa tekstet që janë përgatitur për ngjarjet aktuale (29%) dhe ato që janë përgatitur me ndihmën e investigimeve të gazetarëve (21%) gjenden midis përqindjeve më të larta të të gjitha temave të analizuar;
-  Organizatorët më të shpeshtë të ngjarjeve pseudo janë institucionet publike me 43% dhe institucionet qeveritare me 29%.



## Raportimi i mediave mbi temën „Arsimi dhe të rinjtë“

Sipas interesit të mediave dhe duke vlerësuar sipas numrit të teksteve të publikuara gjatë periudhës së monitorimit, krahasuar me temat e tjera të analizuara, kjo temë është gjetur në mes. Kjo temë përfshin katër nëntema, më saktësisht Cilësinë e arsimit, Largimin e të rinjve, Përfshirjen e të rinjve dhe Arsimin sipas nevojave. Gazetat dhe televizionet kanë pasur interesim të njëjtë për këto tema. Me analizimin e teksteve të publikuara mund të arrihet në konkluzionet më poshtë lidhur me mënyrën në të cilën mediat kanë raportuar mbi këtë temë:

- 📖 Nga një e treta e teksteve të kësaj teme kanë qenë të shkurtra, të mesme dhe të gjata;
- 📖 Dy të tretat e teksteve (65%) nuk janë paralajmëruar në ballinë ose në siglat e lajmeve kryesore, ndërsa vetëm një e treta e tyre (35%) janë paralajmëruar në ballinë ose në siglat e lajmeve kryesore;
- 📖 42% të teksteve janë ilustruar me fotografi ose filmime të përgjithshme, ndërsa 38% prej tyre me fotografi ose filmime autentike;
- 📖 53% të teksteve janë publikuar me emrin dhe mbiemrin e autorit, 27% prej tyre janë publikuar me inicialet e autorit, ndërsa në 20% të teksteve emri i autorit nuk është shënuar;
- 📖 Sipas zhanrit, lajmi dominon në 68% të teksteve, analiza është e pranishme në 20% të teksteve, duke mbajtur një nga përqindjet më të larta të temave të analizuara, ndërsa intervista është e pranishme në 8% të teksteve, që gjithashtu paraqet përqindjen më të lartë nga të gjitha temat e analizuara;
- 📖 58% të teksteve janë përgatitur me dy ose më shumë burime të dhënash, përqindje kjo shumë më e madhe se mesatarja e të gjitha temave të analizuara, megjithëse 8% të teksteve janë përgatitur pa burim të dhënash;
- 📖 Megjithëse pala e prekur me storjen nuk është konsultuar në 48% të teksteve, në 43% të teksteve janë konsultuar dy ose më shumë nga palët e prekura, përqindje kjo shumë më e madhe se mesatarja e të gjitha temave të analizuara;
- 📖 Për 52% të teksteve burime të dhënash kanë qenë institucionet shtetërore, për 13% prej tyre burime të dhënash kanë qenë institucionet arsimore, për 7% të teksteve burime të dhënash kanë qenë ekspertët universitarë ndërsa organizatat civile dhe sektori i biznesit kanë qenë burime të dhënash për 4% të teksteve;
- 📖 Pala e prekur me tekstin është konsultuar dhe mendimi i saj është transmetuar në 47% të teksteve, një përqindje kjo mbi mesataren e të gjitha temave të analizuara;
- 📖 Gjysma e teksteve janë përgatitur si rezultat të ngjarjeve pseudo, organizator kryesor i të cilave (68%) kanë qenë institucionet qeveritare dhe institucionet publike, organizatat civile shfaqen në rolin e organizatorit vetëm në 7% të ngjarjeve, ndërsa sektori i biznesit në rolin e organizatorit të ngjarjeve paraqitet në 5% të rasteve.





## Raportimi i mediave mbi temën „Përfshirja e grupeve të marginalizuara në shoqëri“











Kjo është tema me prani më të vogël në mediat dhe për të zakonisht kanë shkruar gazetaret, për dallim nga televizionet, të cilat gjatë periudhës së monitorimit nuk kanë shprehur interesim për të njëjtën. Analiza e teksteve gazetareske të publikuara për këtë temë siguron rezultatet në vijim:

- Dominojnë tekstet e shkurtra me 42%, megjithëse kjo temë kërkon një elaborim më të thellë dhe më të detajuar;
- Megjithëse 73% të teksteve nuk janë paralajmëruar në ballinë ose në siglat e lajmeve kryesore, 27% prej tyre janë paralajmëruar në ballinë ose në siglat e lajmeve kryesore, që paraqet një nga përqindjet më të larta krahasuar me temat e tjera;
- 46% të teksteve nuk janë ilustruar me fotografi, që gjithashtu nënkupton përqindjen më të lartë të teksteve të pailustruara të të gjitha temave të analizuara, ndërsa me fotografi ose filmime origjinale janë ilustruar vetëm 18% të teksteve, që nënkupton përqindjen më të ulët, krahasuar me temat e tjera;
- Autori i tekstit është plotësisht i njohur vetëm në 27% të teksteve, duke qenë një nga përqindjet më të ulëta;
- Sipas zhanrit, për këtë temë janë përdorur vetëm dy zhanre. Dominon lajmi me 73%, ndërsa analiza është e pranishme me 27%;
- Me një burim të dhënash janë përgatitur 55% të teksteve, por nuk janë konstatuar tekste pa burim të dhënash;
- Për këtë temë janë shënuar të gjitha burimet (100%) dhe nuk janë evidentuar burime anonime;
- Në të shumtën e rasteve (72%) është konsultuar vetëm njëra anë e storjes;
- Organizatat civile si burime të dhënash paraqiten në 33% të teksteve, një përqindje kjo shumë më e lartë nga të gjitha temat e analizuara, institucionet shëndetësore si burime të dhënash janë të pranishme në 17% të teksteve, ndërsa institucionet arsimore në 8% prej tyre;
- Në 63% të teksteve pala e prekur nuk është konsultuar dhe nuk është transmetuar mendimi i saj;
- Ngjarjet pseudo si arsye për përgatitjen e teksteve dominojnë në 64% prej tyre, ndërsa me nga 18% vijojnë ngjarjet autentike dhe investigimet e gazetarëve si arsye për përgatitjen e teksteve;
- Për sa u përket organizatorëve të ngjarjeve, dominojnë organizatat civile me 45%, duke u gjetur para institucioneve shtetërore (36%) dhe sektorit të biznesit (9%).



## Raportimi i mediave mbi temën „Të drejtat e njeriut“

Bëhet fjalë për një temë më gjithëpërfshirëse, e cila si nëntema përfshin Pushtetin gjyqësor, barazinë gjinore, Diskriminimin dhe Lirinë e fjalës. Për sa i përket pranisë në mediat, kjo temë gjendet midis temave më të pranishme për të cilat gazetat dhe televizionet kanë shprehur një interes të barabartë. Me monitorimin e mënyrës në të cilën mediat kanë raportuar lidhur me këto tema mund të arrihet në konkluzionet në vijim:

-  45% të teksteve kanë qenë tekste të gjata, që nënkupton përqindjen e dytë më të lartë të teksteve të gjata nga të gjitha temat e analizuara;
-  77% të teksteve nuk janë paralajmëruar në ballinë ose në siglat e lajmeve kryesore;
-  43% të teksteve janë ilustruar me fotografi ose me filmime origjinale, ndërsa vetëm 15% prej tyre nuk janë ilustruar me fotografi ose filmime;
-  Emri i autorit është publikuar vetëm në 47% të teksteve;
-  Sipas zhanrit, me 79% të teksteve dominon lajmi, pas të cilit vijojnë komentit me 9%, analiza me 6%, intervista me 4% dhe storjet investigative me 2%;
-  64% të teksteve janë përgatitur vetëm me një burim të dhënash, ndërsa pa burim të dhënash janë publikuar vetëm 4% të teksteve;
-  Në 72% të teksteve është paraqitur vetëm njëra anë e storjes;
-  Organizatat civile paraqiten si burimi më i shpeshtë i informatave (29%), pas të cilave vijojnë të gjitha institucionet shtetërore me 17%;
-  Pala e prekur me storjen nuk është konsultuar në 60% të teksteve;
-  Në dy të tretat e teksteve (66%) arsyeja e përgatitjes së tyre kanë qenë ngjarjet pseudo, ndërsa si organizatorë më të shpeshtë të këtyre ngjarjeve paraqiten organizatat civile me 23% dhe institucionet shtetërore me 15%.

EU

## Raportimi i mediave mbi temën „Anëtarësimi në BE“













Kjo është tema me prani më të madhe nga dhjetë temat e analizuar, ndërsa gazetat kanë publikuar më shumë tekste lidhur me këtë temë, krahasuar me televizionet. Analiza e mënyrës në të cilën kanë raportuar mediat mbi këtë temë siguron konkluzionet në vijim:

- EU** 44% të teksteve janë tekste të gjata;
- EU** 36% të teksteve janë paralajmëruar në ballinën e gazetave ose në siglat e lajmeve kryesore të televizioneve, duke qenë tema më e paralajmëruar nga të gjitha temat e analizuar;
- EU** Vetëm 14% të teksteve janë publikuar pa fotografi, megjithëse 55% prej tyre janë ilustruar me fotografi ose filmime të përgjithshme;
- EU** Emri i autorit është publikuar vetëm në 55% të teksteve;
- EU** Sipas zhanrit, dominon lajmi me 59% të teksteve, megjithëse 17% të teksteve janë komente, një përqindje kjo shumë më e lartë krahasuar me temat e tjera që kanë qenë objekt analize;
- EU** 19% të teksteve janë përgatitur pa burim të dhënash, që e bën këtë temë të jetë tema me më shumë tekste me autorë anonimë nga të gjitha temat e analizuar;
- EU** Në 56% të teksteve është konsultuar vetëm njëra anë e storjes;
- EU** Si burime informatash dominojnë partitë politike me 15%, një përqindje kjo më e lartë nga të gjitha temat e analizuar, duke u gjetur para institucioneve shtetërore (17%), ekspertëve universitarë (6%) dhe organizatave civile (3%);
- EU** Në 62% të teksteve pala e prekur me storjen nuk është konsultuar dhe nuk është transmetuar mendimi i saj;
- EU** Ngjarjet pseudo kanë qenë arsye për përgatitjen e teksteve në 62% të rasteve;
- EU** Për sa u përket organizatorëve të ngjarjeve, dominojnë partitë politike dhe institucionet shtetërore.



## Raportimi i mediave mbi temën „Sundimi i mirë“











Bëhet fjalë për një temë të komplikuar, e cila në vetvete përfshin nëntemat Trasparenca dhe llogaridhënia, Korrupsioni, Administrata publike, Cilësia e shërbimeve dhe Zgjedhjet. Kjo temë gjendet midis temave për të cilat mediat kanë publikuar tekste më shpesh dhe midis temave më të rralla për të cilat më shumë tekste kanë publikuar televizionet, krahasuar me gazetat. Analiza e teksteve të publikuara siguron konkluzionet në vijim:

-  Për sa i përket gjatësisë së teksteve, tekstet e shkurtra, të mesme dhe të gjata marrin pjesë me një përqindje të njëjtë;
-  80% të teksteve nuk janë paralajmëruar, ndërsa 20% prej tyre janë paralajmëruar në ballinë ose në siglat e lajmeve kryesore;
-  46% të teksteve janë ilustruar me fotografi ose filmime origjinale;
-  Në 35% të teksteve nuk është shënuar emri i autorit;
-  Sipas zhanrit, dominon lajmi me 81%, pas të cilit vijon komenti me 11% dhe analiza me 4%;
-  Me vetëm një burim të dhënash janë publikuar 69% të teksteve, që paraqet përqindjen më të lartë të të gjitha temave të analizuara;
-  7% të burimeve të të dhënave janë anonime, që paraqet përqindjen më të lartë, krahasuar me temat e tjera që kanë qenë objekt analize;
-  Në 76% të teksteve është konsultuar vetëm njëra anë e storjes, që paraqet përqindjen e dytë më të lartë, krahasuar me temat e tjera që kanë qenë objekt analize;
-  Një të tretat e burimeve të informatave janë siguruar me ndihmën e institucioneve shtetërore, 20% të burimeve janë siguruar me ndihmën e partive politike, ndërsa 8% me ndihmën e organizatave civile;
-  Pala e prekur nuk është konsultuar në 57% të teksteve, ndërsa në 41% prej tyre ajo është konsultuar dhe ka dhënë deklaratë;
-  Në pjesën më të madhe të teksteve (74%) si arsye për përgatitjen e tekstit kanë shërbyer ngjarjet pseudo, një përqindje kjo më e lartë nga të gjitha temat e analizuara, ndërsa investigimet e gazetarëve, si arsye për përgatitjen e teksteve, paraqiten vetëm në 2% të teksteve, që njëkohësisht është përqindja më e ulët e të gjitha temave të analizuara;
-  Në 45% të teksteve në rolin e organizatorit të ngjarjeve paraqiten institucionet shtetërore, pas të cilave vijnë organizatat civile me 15%, partitë politike me një përqindje të njëjtë dhe institucionet gjyqësore me 11%.



## Raportimi i mediave mbi temën „Raportet ndëretnike“

Kjo është një nga temat me prani më të vogël në mediat, krahasuar me temat e tjera që kanë qenë objekt analize. Në këtë temë përfshihen aspektet në vijim të marrëdhënieve ndëretnike: multikulturalizmi, arsimi, siguria dhe ndikimi në ekonomi. Televizionet për këtë temë kanë raportuar më shpesh, krahasuar me gazetatat. Me analizimin e teksteve të publikuara në mediat mund të sigurohen konkluzionet në vijim:


-  Tekstet e shkurtra dhe tekstet e gjata në kuadër të kësaj teme janë të pranishme me nga 47%;
-  79% të teksteve janë paralajmëruar në ballinë ose në siglat e lajmeve kryesore, ndërsa 21% prej tyre nuk janë paralajmëruar;
-  Mbi gjysma e teksteve janë ilustruar vetëm me fotografi ose filmime të përgjithshme që përputhen me temën, por jo edhe me ngjarjet autentike;
-  80% të teksteve janë lajme, ndërsa 5% janë storje investigative, reportazhe, intervista dhe komente;
-  65% të teksteve kanë vetëm një burim të dhënash, ndërsa 5% prej tyre nuk kanë asnjë burim të dhënash;
-  Për 68% të teksteve është konsultuar vetëm njëra anë e storjes;
-  Pjesa më e madhe e burimeve (63%) janë siguruar me ndihmën e institucioneve shtetërore, për 11% të teksteve burimet janë siguruar me ndihmën e organizatave civile, ndërsa partitë politike, institucionet shëndetësore dhe ekspertët universitarë marrin pjesë me nga 5% në sigurimin e burimeve të të dhënave;
-  Pala e prekur nuk është konsultuar në 63% të teksteve;
-  Ngjarjet pseudo kanë qenë arsye për përgatitjen e teksteve në 63% të rasteve;
-  Midis organizatorëve të ngjarjeve dominojnë institucionet shtetërore me 37%, pas të cilave vijojnë partitë politike me 16% dhe organizatat civile me 11%.




## Krahasimi i mënyrës së raportimit sipas temave

Në vazhdim është dhënë paraqitje grafike e disa nga aspektet më të rëndësishme dhe më interesante të monitorimit të mënyrës në të cilën mediat kanë raportuar mbi temat me interes shoqëror.


### 14. Teksti është paralajmëruar në allinë / në lajmet kryesore




### 15. Tekti është ilustruar me fotografi / filmime origjinale




## 16. Në tekst është shënuar emri dhe mbiemri i autorit




## 17. Përqindja e storjeve investigative




## 18. Tekste pa burime të dhënash




### 19. Janë kontaktuar dy ose më shumë nga anët e storjes



### 20. Institucionet shtetërore si burim të dhënash




### 21. Organizatat civile si burim të dhënash







## 22. Është konsultuar pala e prekur



## 23. Ngjarjet pseudo si arsye për punimin e teksteve



## 24. Organizatat civile si organizatorë të ngjarjeve





# REKOMANDIMET

- 1** Mediat të intensifikojnë informimin e opinionit për temat me rëndësi shoqërore, duke u mundësuar qytetarëve më shumë informata që u nevojiten atyre për të marrë pjesë reale dhe në mënyrë efikase në proceset që kanë ndikim në jetën dhe punën e tyre.
- 2** Gazetarët të zbatojnë standardet profesionale elementare në rastet e raportimit për temat me rëndësi shoqërore, duke raportuar saktë, në mënyrë të balancuar dhe fer dhe duke u kujdesur për saktësinë, besimin dhe kredibilitetin e teksteve të tyre, më saktësisht:
  - Të publikojnë fakte;
  - Të kontrollojnë dhe vërtetojnë informatat e fituara;
  - Të pasurojnë listat e burimeve dhe të citojnë më shumë se një burim të dhënash;
  - T'i përfshijnë dhe t'i konsultojnë të gjitha anët e storjes;
  - T'i trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjitha palët e storjes;
  - Të sigurojnë dhe të ofrojnë prova për historitë e tyre;
  - Në të gjitha rastet kur është e mundur të ilustrojnë tekstet me fotografi dhe filmime origjinale dhe autentike;
  - Të nënshkruajnë tekstet e tyre.
- 3** Gazetarët të praktikojnë që pronarët të mbështesin, ndërsa redaktorët të inkurajojnë gazetarinë hulumtuese lidhur me temat me interes shoqëror, si një mënyrë në të cilën mediat do të realizojnë rolin e tyre shoqëror dhe të risin besimin dhe kredibilitetin në opinion, duke rritur njëkohësisht edhe të ardhurat e tyre.
- 4** Mediat të investojnë (mjete, kohë, teknikë dhe përpjekje) për edukimin plotësues të gazetarëve dhe redaktorëve, jo vetëm për të respektuar standardet profesionale elementare të profesionit, por për të pasuruar teknikat e gazetarisë investigative.

- 5 Mediat t'u mundësojnë gazetarëve të drejtat dhe mbrojtje plotësuese për të informuar opinionin me profesionalizmin dhe objektivitetin e duhur, ndërsa gazetarët në këtë drejtim të mbështeten në dispozitat ligjore në fuqi.
- 6 Shoqatat dhe organizatat esnafe duhet të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të siguruar kushtet e nevojshme që gazetarët dhe profesionistët e tjerë të mediave të realizojnë detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe të liruar nga frika dhe presionet.
- 7 Organizatat civile duhet të forcojnë kapacitetet e tyre të brendshme për të siguruar një bashkëpunim më intensiv dhe më të suksesshëm me mediat, duke ua ofruar mbështetjen e nevojshme (në aspektin e ekspertëve dhe resurseve) gjatë hulumtimit dhe raportimit për temat me rëndësi shoqërore.
- 8 Organizatat civile të krijojnë raporte që sigurojnë komunikim të vazhdueshëm dhe jo komunikim ad-hok me mediat, duke ua ofruar mbështetjen e nevojshme (nga aspekti i ekspertëve dhe resurseve) gjatë hulumtimit dhe raportimit për temat me rëndësi shoqërore.
- 9 Organizatat civile në të gjitha projektet që i realizojnë, që kanë të bëjnë me interesin shoqëror, duhet të zhvillojnë aktivitete për edukimin e gazetarëve për të siguruar një informim më cilësor të qytetarëve.
- 10 Organizatat civile dhe mediat duhet të forcojnë bashkëpunimin në drejtim të realizimit të rolit të tyre shoqëror si faktorë kryesorë të proceseve demokratike në vend.
- 11 Donatorët vendas dhe të huaj të vazhdojnë përpjekjet për mbështetjen e gazetarëve, mediave dhe organizatave civile në drejtim të informimit profesional dhe objektiv të opinionit lidhur me proceset dhe temat me rëndësi shoqërore.



CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека  
"Св. Климент Охридски", Скопје

070.4:304.9(497.7)"2013"(047)

REZULTATET e monitorimit të raportimit të  
mediave lidhur me temat  
me interes shoqëror, të definuara bashker-  
isht nga ana e gazetarëve  
dhe përfaqesuesve të organizatave civile ne  
Maqedoni. - Shkup :  
Rrjeti ballkanik i investigimit dhe raportimit  
(BIRN), 2013. - 37  
стр. : граф. прикази ; 23 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-65520-2-2

а) Медиуми - Уредувачка политика -  
Општествени прашања -  
Македонија - 2013 - Извештаи  
COBISS.MK-ID 96194314



